



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithëshme
Zyra e Prokurimit



Shkresë	17/10/2018
Nga:	Zyra e Prokurimit MENSUR GLLAREVA
Te:	NTSH "NAZI TRAVEL"
Lënda:	VENDIM

Konform Ligjit mbi Prokurimin Publik, Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, përkatësisht Neni 108/A pika 10.1 dhe Rregullave për parashtrimin e kërkesës për Ri-shqyrtim të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues, Zyra e Prokurimit, nxjerrë:

Vendim

1. Refuzohet kërkesa për Ri-shqyrtim të njoftimit mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues: FURNIZIMI ME DRU ZJARRI (BUNGU&QARRI) PER NEVOJAT E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE SHENDETSORE NE DRENAS) si e pabazuar dhe
2. Vazhdohet me procedurën e prokurimit.

Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për Ri-shqyrtim është i bazuar në gjendjen reale të zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Arsyetim :

- a) Pretendimet e cekura në kërkesën Tuaj siq thoni, 1. Është shkelur Neni 58 Hapja e Tenderit paragrafi 3 e LPP nuk qendrojnë sepse që nga fillimi i procesit të hapjes I keni organizuar OE-të pjesëmarrëse që të kontrollojnë dosjen e tenderit OE-së I cili ishte me çmim më të lire. OE me I lire nuk e ka pranuar që të kontrollohet dosja e tenderit nga ana e OE-ve tjere sepse ligjërisht kompetent për të kontrolluar komplet dokumentacionin e ofruar në dosjen e tenderit është komisioni I vleresimit ndërsa OE-te pjesëmarrëse kanë të drejtë të shikojnë vetëm Formularin e Tenderit dhe Paramasen e cila edhe është nënshkruar nga njeri prej pjesëmarrësve. Zyrtari I prokurimit e ka terhequr vërejtjen që mos të shkruhen fjale të pabazuara në procesverbal të hapjes për arsye sepse nuk mund të jesh I sigurt se qfare dokumentacioni I ka në dosje të tenderit dhe keni shprehur fjale fyese ndaj komisionit dhe zyrtarit të prokurimit duke u shprehur me fjalet "Une jam bossi dhe mund të kontrolloj dosjen e tenderit". Pas perfundimit të hapjes keni ikur me shpejtesi dhe jeni larguar nga Zyra e Prokurimit. Komisioni I hapjes së bashku me Zyrtar të prokurimit e kanë lexuar vërejtjen e shkruar nga ana juaj në procesverbal ku thoshte se I mungon plani dinamik dhe menjëherë e kemi kontrolluar DT dhe plani dinamik ishte I vendosur në fund të DT dhe e kemi ngritur në sistemin elektronik të prokurimit formën perfundimtare duke I hudhur poshtë pretendimet e juaja se plani dinamik nuk ndodhet në DT. Një veprim I tillë është bërë nga ju me qëllim të perfitimt pasuror duke falsifikuar procesverbalin e hapjes i cili është dokument me karakter publik dhe për këtë arsye menjëherë kemi konstatuar gjendjen faktike .
- b) Autoritet kontraktues (Komuna e Drenasit) I ka trajtuar në mënyrë të barabartë të gjithë OE në bazë të kriterëve të përcaktuara në Njoftimin për Kontrate dhe Dosje të Tenderit.

- c) Komisioni i Vlerësimit gjate vleresimit te tendereve i ka respektuar ne perpikeri kriteret e percaktuara ne Njoftimin per Kontrate dhe Dosje te Tenderit.
- d) OE eshte i pajisuar me Qertifikaten e Biznesit dhe ka prezentuar listen e kontratave dhe referencave dhe ka deshmi plotesuese se pagesat jane kryer ne menyre te rregullt permes sistemit bankar dhe ne llogari te Wood Company.
- e) OE pas kerkeses per informata shtese, AK menjehere e ka shqyrtuar ate kerkese dhe ka konstatuar se nuk ka nevojte per informacione shtese sepse te gjitha pyetjet e juaja kane qene te sqaruara ne Njoftimin per Kontrate dhe Dosjen e Tenderit.
- f) Eshte respektuar afati kohor sepse nga njesia kerkuese ka kerkuar qe procedura te zhvillohet me afat te shkurtuar per shkak te kushteve atmosferike dhe gjendjes jo te mire te shkollave per furnizim me dru.
- g) Eshte respektuar Validiteti i Tenderit i cili ka qene ne Njoftimin per Kontrate dhe Dosje te Tenderit dhe i njejte per te gjitha OE-te.

Pala e pakenaqr me kete vendim ka te drejte ankese ne OSHP.

[Sheno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs të projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Aktiviteti i prokurimit "Furnizimi me Dru Zjarri (Bungu & Qarri) për nevojat e institucioneve Arsimore dhe Shëndetësore-Drenas" është publikuar me datë 31.08.2018, afati i fundit për dorëzimin e ofertave ka qenë 27.09.2018. Ofertat i kanë dorëzuar 5 operator ekonomik. Hapja e ofertave është bërë me datë 27.09.2018 në ora 14:00.

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☒

Jo ☐

Është shkelur neni Neni 58 Hapja e Tenderëve, paragrafi 3 ngase procesverbali i hapjes së ofertave pas përfundimit të takimit të hapjes dhe dhënjes së kopjes për të gjithë pjesëmarrësit në hapje, është modifikuar nga zyrtari i prokurimit, respektivisht janë shtuar shënime shtesë me shkrim në procesverbalin e hapjes.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

AK K.K. Drenas ka shkelur dispozitat në vijim të Ligjit për Prokurim PUBLIK Nr. 04/L-042 dhe Rregullës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurim Publik:

- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi i LPP-së;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve, paragrafi 1 dhe paragrafi;
- Neni 66 Përshtatshmëria Profesionale, paragrafi 1;
- Neni 53 i LPP-se "Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit" dhe nenet 25.4, 25.5 dhe 25.7 të Rregullorës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik "Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore";
- Neni 44, paragrafi 2, pika 1 "Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje";
- Neni 31, paragrafi 2 i Rregullorës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik "Validiteti i Tenderit";

7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

OE N.T.SH. "Nazi Travel" konsideron se AK K.K. Drenas nuk e ka trajtuar drejtë/barabrtë dhe në bazë të kriterëve të vendosura në dosjen e tenderit oferten e tij. Detajet mbi faktet dhe argumentet e OE N.T.SH. "Nazi Travel" janë si në vijim:

Është shkelur neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, paragrafin 2 të LPP-së duke ekzekutuar aspekte të aktivitetit të prokurimit që reduktojnë konkurrencën në mes të operatorëve ekonomik dhe diskriminojnë në dëm të operatorit ekonomik N.T.SH. "Nazi Travel" dhe duke mos i shqyrtuar drejtë dokumentet e ofruara nga O.E të cilit i është dhënë kontrata gjatë procesit të ekzaminimit, vlerësimi dhe krahasimit të tenderëve;

Është shkelur neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve, paragrafi 1 sipas të cilit të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës dhe paragrafi 4 sipas të cili autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit që kemi marr nga AK K.K.Drenas gjatë qasjes në dokumentet publike shihet se komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të tenderëve nuk i ka respektuar kriteret e parashtuara në dosjen e tenderit. Në dosjen e tenderit të "Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale" është kërkuar "Lista e Referencave – origjinal të natyrës së ngjajshme, të bashkangjitura me kopjet e pranimeve, proceseve apo referencave ne 3 vitet e shkuara (2015, 2016 dhe 2017) ku identifikohet qartë, shuma, nr. i prokurimit, viti, titulli etj)". Komisioni i vlerësimit ka pranuar si valide kontratat e nënshkruar nga VIVA FRESH STORE SH.P.K dhe Wood Company sh.p.k, të cilat nuk janë të vullosura, nuk përmbajn numer të prokurimit (siç është kërkuar në dosjen e tenderit), data e lëshimit të referencave është e njëjtë për referencat e lëshuara për të tri vitet (2015, 2016 dhe 2017) si dhe kontratat janë nënshkruar me numer të Certifikatës së TVSH-së për kompanin Wood Company sh.p.k dhe jo me numer të regjistrimit të biznesit.

Gjithashtu, komisioni i vlerësimit ka pranuar si të vlefshëm planin dinamik të ofruar nga Wood Company sh.p.k që është një tabelë e hijëzuar me 96 katror dhe një shënim ku thuhet sasia e përafërt ditore 100 mh dhe numri i diteve 50. Kërkojm nga Zyra e Prokurimit që të na tregoj si është lexuar dhe kuptuar nga komisioni i vlerësimit plani dinamik, apo është vlerësuar vetëm si dokument fizik. Nëse është vlerësuar si dokument fizik sa do të jetë sasia e masës drusore që do t'i kërkohej O.E Wood Company sh.p.k të shpërndahet brenda një dite.

Përveç kësja, ne gjatë shqyrtimit të dokumentacionit i kemi vërejtur mosperputhje në mes të "Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave", listës së kontratave origjinale të përgatitur nga kompania Wood Company sh.p.k dhe kontratave dhe referencave.

Rrjedhimisht në dokumentin "Formulari i deklarimit vjetor dhe pagesës për tatimin në të ardhurat e korporatave" të ardhurat bruto janë 52,951.00 €, ndërsa referenca për kontratën e nënshkruar në mes të O.E VIVA FRESH STORE SH.P.K dhe Wood Company sh.p.k për periudhën 26.10.2015 deri me 12.04.2016 është në shumën 85,970.86 €. Një

mospërputhje tjetër vërehet edhe në datat e kontratës për 2015, që janë 26.10.2015 deri me 12.04.2016 dhe datave për të cilën është lëshuar referenca që janë 01.11.2015 deri me 12.04.2016. Gjithashtu vërehet edhe mospërputhje në mes të vlerës së kalkuluar në total në referencë që është 85,970.86 € dhe vlerës totale kur shumëzohet çmimi për njësi dhe sasia e përcaktuar në kontratën e cekur më lartë $((32.00 \text{ €} + \text{tvsh } 5.76 \text{ €}) \times 2,281.2) = 86,138.11 \text{ €}$.

Të njëjtat mospërputhje janë paraqitur edhe në kontratën e nënshkruar në mes të O.E VIVA FRESH STORE SH.P.K dhe Wood Company sh.p.k për periudhën 25.04.2016 deri me 27.09.2017. Respektivisht vërehet mospërputhje në datat e kontratës për 2016, që janë 25.04.2016 deri me 27.09.2017 dhe datave për të cilën është lëshuar referenca që janë 01.15.2016 deri me 27.09.2017. Gjithashtu vërehet edhe mospërputhje në mes të vlerës së kalkuluar në total në referencë që është 137,314.00 € dhe vlerës totale kur shumëzohet çmimi për njësi dhe sasia e përcaktuar në kontratën e cekur më lartë $((32.00 \text{ €} + \text{tvsh } 5.76 \text{ €}) \times 3,753.80) = 141,743.49 \text{ €}$.

Është shkelur neni 66 Përshtatshmëria Profesional, paragrafi 1 sipas të cilit O.E Wood Company sh.p.k ka ofruar Çertifikatën e Regjistrimit të Biznesit, e cila tregon se kompania në fjalë është regjistruar me 26.11.2015, ndërsa për dëshmi të referencave ka ofruar kontratën dhe referencën e nënshkruar dhe të lëshuar nga VIVA FRESH STORE SH.P.K me data më të hershme se sa themelimi i kompanisë Wood Company sh.p.k. Me konkretisht, nga dokumentet që ne kemi marr në AK K.K. Drenas gjatë qasjes publike shihet se VIVA FRESH STORE SH.P.K ka nënshkruar kontratë me kompaninë Wood Company sh.p.k me datë 26.10.2015, për periudhën deri me 12.04.2016. Pra kontrata në mes të VIVA FRESH STORE SH.P.K dhe Wood Company sh.p.k është nënshkruar me datë 26.10.2015, ndërsa kompania Wood Company sh.p.k është regjistruar nga Agjencioni i Regjistrimit të Bizneseve me datë 26.11.2015, një muaj më vonë (shih ÇRB). Kontrata e nënshkruar më data më të hershme se sa data e themelimit të kompanisë janë dëshmi që tregojn se kontratat janë fiktive.

Është shkelur neni 53 I LPP-se "Sigurimi i informatave shtesë për kandidatët dhe tenderuesit" dhe nenet 25.4, 25.5 dhe 25.7 të Rregullorës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik "Ofrimi i informacioneve shtesë ose sqarimeve dhe zgjatjet e afateve kohore" duke mos na u përgjigjur në kërkesën tonë për sqarime shtesë. Një përgjigje jo adekuate dhe pa asnjë sqarim në kërkesën tonë për informata shtesë duke na e mohuar nevojën tonë për informata, na është dhënë në orët e fundit të ditës para datës së fundit për dorëzimin e tendereve. LPP dhe legjislacioni sekondar i obligon AK që të japin informacione shtesë.

Është shkelur neni 44, paragrafi 2, pika 1 "Rregullat e Përgjithshme për Caktimin e Afateve Kohore për pranimin e Tenderëve ose Kërkesave për Pjesëmarrje" sipas të cilit kur kontrata përkatëse është kontratë publike me vlerë të madhe, afati kohor për pranimin e tenderëve duhet jo më pak se dyzet (40) ditë" plus 5 ditë në platform, ndërsa afati i përcaktuar nga Zyra e Prokurimit në K.K. Drenas, ka qenë 29 ditë, kështu që hapja ka ndodhë në ditën e 29 pa shkurtim afati duke përfshirë edhe ditët obliguese në platformë).

Është shkelur neni 31, paragrafi 2 i Rregullorës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik "Validiteti i Tenderit" në të cilin thuhet se "Kërkesa për periudhë të validitetit të tenderit do të jetë në minimum 90 ditë për kontrata me vlerë të madhe" dhe krahas kësaj është bërë shkelje edhe në afatin e sigurisë së tenderit. Afati i kërkuar për aktivitetin në fjalë për validitetin e tenderit është 60 ditë, ndërsa afati i garancionit të tenderit 90 ditë.

Është shkelur neni 18, paragrafi 4 Rregullorës dhe Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik sipas të cilit "Kërkesat e përcaktuara në Dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë duhet të jenë identike".

8. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'iu shkaktojë dëme materiale, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

OE N.T.SH. "Nazi Travel" është taksapagues i rregullt i taksave dhe tatimeve të vendosura me ligjet dhe aktet tjera nën ligjore të Republikës së Kosovës, që janë pjesë e të hyrave shtetërore dhe se një diskriminim dhe trajtim jo i bartabart nga ana e autoriteteve komunale e dëmton dhe pamundëson materialisht zhvillimin dhe funksionimin e veprimtarisë së operatorit N.T.SH. "Nazi Travel".

9. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë";
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës";
- c) një kopje të letrës së tenderuesit të pasuksesshëm;
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve që ju është shpërnda pjesëmarrseve në hapje dhe një kopje të procesverbalit të modifikuar nga zyrtari i prokurimit;
- e) një kopje të ÇRB-së dhe kontratës për vitin 2015.